

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **611-25-2667-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Paisje stomatologjike per nevoja te QKMF**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

” Pro Medical.”

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kadri Zeka

(Adresa)

Ferizaj

70000

(Vendi)

(Kodi postar)

049-631-245

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Adnan Bala

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

promedical.fr@gmail.com

(Adresa elektronike)

18.04.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate: 19.03.2025

Hapja e ofertave: 23.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura të LPP-së:

Neni 7: Barazia dhe Jo-Diskriminimi

Neni 27 Dosja e Tenderit

Neni 28: Specifikimet Teknike

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne kemi vërejtur se Dosja e Tenderit nuk është në përputhje me Nenin 27 të LPP-së, pasi paramasat e vendosura për këtë aktivitet prokurimi janë në kundërshtim me LPP-në si dhe Neni dhe Neni 28 të LPP.

Kërkesa jonë ka të bëjë me faktin se specifikimet teknike të detyrueshme janë hartuar në mënyrë që i përshtaten në tërësi një prodhuesi të caktuar, duke shkelur parimet e barazisë dhe jo-diskriminimit të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Kjo favorizim dhe diskriminim ndaj prodhuesve të tjerë dhe operatorëve ekonomikë (OE) që shprehin interes për ofertim nëpërmjet procedurës së hapur, e cila ka si qëllim promovimin e konkurrencës dhe trajtimin e barabartë.

Neni 7: Barazia dhe Jo-Diskriminimi

Ky nen është parimi bazë i Prokurimit Publik, i cili përcakton se autoriteti kontraktues duhet të trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, duke vepruar në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktues nuk duhet të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën midis operatorëve ekonomikë ose që diskriminon një ose më shumë prej tyre.

Neni 28: Specifikimet Teknike

Përpilimi i specifikimeve teknike nga njësi e kërkesës është në kundërshtim me Nenin 28, paragrafi 2, i cili përcakton se autoriteti kontraktues duhet t'i hartojë specifikimet teknike në mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë. Hartimi i specifikimeve teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë është i ndaluar. Specifikimet aktuale kufizojnë konkurrencën dhe trajtimin e barabartë, duke diskriminuar prodhuesit e tjerë që nuk mund të plotësojnë kushtet teknike.

3. Autokllav 40-50 liter.....2copë (kokmplet sipas specifikave 3.1,3.2)

- Specifikat: Kapaciteti i dhomes XL-kapaciteti deri ne 25 kg me 16 tabak ose 10 kuti mel-astori
- Shpejtesia mbreseleneze – teknologji per koha pune rekorde
- Tharje inteligjente, shkurtimi i kohes se tharjes ne drytellicenc deri ne 80%

Options? Unlimited!

Four instruments deserve greatness: The new XL chamber design, record cycle times and high loading capacities offer maximum versatility - and even more space for instruments up to 25 kg and 16 trays.

DRYtelligence®

Rely on perfect results: DRYtelligence® optimally adapts the drying process to your load. The intelligent algorithm reduces the drying time by up to 80 % - and thus saves a lot of time, money and energy.

Ne kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që përshkrimi i cekur më lart të mos merret parasysh gjatë ofertimit dhe krahasimit të ofertave për këtë pozitë, pasi është e qartë që është përzgjedhur një brand i caktuar dhe i njohur për ne, gjë që në një mënyrë përbën favorizim. Për më tepër, duket qartë se përshkrimi është bërë përmes një kopjimi të drejtpërdrejtë (copy/paste). Prandaj, kërkojmë që ky përshkrim të mos merret parasysh.

2. Autokllav B clas me printer te integruar 23-25 lit6 copë (komplet sipas specifikave 2.1,2.2)

1. Klasifikimi clas B
2. Printer I përfshirë në autokllav
3. Izolimi clas 2
4. Fuqia min 220v/50Hz : 220v/160Hz; 115v/60Hz
5. Konsumimi energjisë min 2000W
6. Sigurimi rrjetit F 15A
7. Niveli zhurmës min 50dB (A)
8. Test programues Helix /BD Test; vacuum test
9. Temperatura e punës 121°C -134°C
10. Koha e ngrohjes paraprake përafërsisht 20 min

Arsyetim për largimin e pikave 5, 6,7 dhe 10 nga specifikat teknike për pozicionin "Autokllav B Class me printer të integruar 23-25 litra – 6 copë "

Ne kërkojmë që pikat 5, 6,7 dhe 10 të largohen nga specifikimet teknike për këtë pozicion, me arsyetimin si vijon:

Pika 5 – Konsumimi i energjisë min 2000W: Kjo kërkesë është e kufizuar dhe favorizon pajisje specifike. Në treg ka autokllava që plotësojnë të gjitha standardet e nevojshme të klasës B dhe funksionalitetet përkatëse, por që kanë konsum më të ulët të energjisë, gjë që në fakt është edhe më e favorshme për efikasitetin energjetik.

Pika 6 – Sigurimi i rrjetit F 15A: Edhe kjo pikë është e panevojshme për t'u specifikuar në këtë mënyrë të ngushtë, pasi siguresat varen nga konfigurimi i rrjetit elektrik të institucioneve dhe jo domosdoshmërisht nga vetë pajisja. Kërkesa e tillë mund të përjashtojë modele që janë të përshtatshme dhe të certifikuar, por që operojnë me konfigurime të tjera të zakonshme.

Pika 7 – Niveli i zhurmës min 50 dB (A): Edhe kjo specifikë duhet të trajtohet me kufij minimal dhe maksimal, dhe jo si vlerë fikse, pasi niveli i zhurmës duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të jetë i zbatueshëm në praktikë. Vendosja e një vlere të vetme si kërkesë minimale mund të përjashtojë pajisje që janë në përputhje me standardet, por që kanë variacione të vogla në këtë parametër, pa ndikuar në cilësinë apo sigurinë e pajisjes.

Pika 10 – Koha e ngrohjes paraprake përafërsisht 20 min: Kjo është një specifikë që ndryshon nga modeli në model dhe nuk ndikon drejtpërdrejt në cilësinë apo performancën e sterilizimit. Kjo kohë varet nga faktorë të ndryshëm si madhësia e dhomës, teknologjia e përdorur dhe ambienti i punës. Kjo kërkesë kufizon pjesëmarrjen e pajisjeve të tjera cilësore që mund të kenë kohë ngrohjeje pak më të gjatë ose më të shkurtër.

Për më tepër, në pozicionin 2 ju keni cekur këto pika (5, 6 dhe 7), që tregon një përsëritje të paarsyeshme që ndikon në barazinë e konkurrencës. Për të garantuar një proces të drejtë dhe konkurrues, kërkojmë që këto pika të largohen nga specifikat teknike..

Prandaj, në funksion të sigurimit të konkurrencës së drejtë dhe mosfavorizimit të ndonjë operatori apo brendi të caktuar, kërkojmë që këto pika të largohen nga dokumentacioni i tenderit.

Tek ky pozicion me poshte ju keni cekur si:

2.2 Makina e vulosjess –specifikat:

● Tubi i siguresave: T3A

Në lidhje me specifikimin “Tubi i siguresave: T3A”, dëshirojmë të theksojmë se ky element nuk ka më rëndësi teknike apo relevancë, pasi modelet e reja të makinave që ndodhen aktualisht në treg përdorin një sistem të modifikuar operimi dhe nuk funksionojnë më me tuba specifike të tipit T3A.

Për këtë arsye, kërkojmë që ky specifikim teknik të mos merret në konsideratë, pasi nuk është në përputhje me standardet aktuale të tregut, dhe propozojmë që ai të hiqet nga specifikimet teknike pra” **Tubi i siguresave: T3A**”

Tek pozicioni 6 si me poshtë ju keni cekur si:

6 Kompresori ajrit pa vaji , pa zhurmë1 cope

1. Kapaciteti 50-60 lit. ne minut
2. Motorri 650-750 W
3. Shtypja 0.8Mpa deri 1 Mpa
4. Voltazha 220V-240V 50Hz
5. Tank (kapaciteti) min. 35 lit.
6. Pesha 25-28 kg
7. Zhurma 60-65 dB

Tek pika 1, keni specifikuar një kapacitet prej 50–60 litra në minut, por kur kemi të bëjmë me një tank me kapacitet 35L, sipas standardeve, kapaciteti i prodhimit të ajrit është 150 L/min, çka përfaqëson një zgjidhje më të avancuar.

Tek pika 2, modeli që keni përfshirë, edhe pse përmban gabime, varion sipas standardeve nga 650–850W, dhe kjo duhet të reflektohet në specifikimet teknike.

Tek pika 7, për nivelin e zhurmës 60–65 dB, ju e keni prezantuar kompresorin si "pa zhurmë", ndërkohë që kjo vlerë është mbi kufirin e lejuar. Sipas standardeve, niveli i zhurmës nuk duhet të kalojë 55 dB, prandaj kërkohet një pajisje me zhurmë më të ulët sesa ajo që keni përshkruar.

Për këto arsye, kërkojmë që specifikimet teknike të rishikohen dhe të modifikohen në përputhje me standardet përkatëse.:

Është

Duhet të jetë në përputhje me standardet përkatëse.

1. **Kapaciteti 50-60 lit. ne minut**
2. **Motorri 650-750 W**
3. **Shtypja 0.8Mpa deri 1 Mpa**
4. Voltazha 220V-240V 50Hz
5. Tank (kapaciteti) min. 35 lit.
6. Pesha 25-28 kg
7. **Zhurma 60-65 dB**

1. Kapaciteti min 100- max 150 lit. ne minut
2. Motorri 650-850 W
3. Shtypja fillon nga 0.0Mpa deri 1Mpa
4. Voltazha 220V-240V 50Hz
5. Tank (kapaciteti) min. 35 lit.
6. Pesha 25-28 kg
7. Zhurma 55-65 dB



Fota reale



Duke marrë parasysh që produktet përkatëse ndodhen aktualisht në stokun tonë dhe pas një ekzaminimi fizik të kryer si dhe komunikimeve me furnitorët tanë, është konstatuar se specifikimet teknike të kërkuara përmbajnë gabime, pasi nuk janë në përputhje me standardet përkatëse, ku kemi bashgjitur edhe disa foto.

Kërkesa për Modifikim

Si palë me interes material për këtë aktivitet prokurimi, kërkojmë nga njësia e kërkesës:

- Të modifikojë specifikimet teknike të detyrueshme për këtë furnizim, duke lejuar konkurrencën midis prodhuesve.

- Të sigurojë që specifikimet teknike janë gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese, duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë sipas LPP-së.

- Të pranojë pajisje me performanca më të mira, duke lejuar devijime brenda standardeve ndërkombëtare për plotësimin e nevojave reale.

Pra, për shkak të gabimeve teknike në përpilimin e paramasës nga ana e njësisë kërkuuese, ne si operator ekonomik po dëmtohem dhe si rezultat, ky aktivitet i prokurimit është në rrezik të dështimit. Kjo për shkak se specifikimet teknike kanë devijuar dhe nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian për pajisjet e cekura në paramasë. Për këto arsye, kërkojmë që kërkesa dhe arsyetimet tona të cekura më lart të merren parasysh, ose me qëllim është duke bërë këtë veprim njësia kërkuuese.

VENDIMI

Aprovohet Ankesa si e bazuar

Të korrixhohet text ne paramase e cekur me lartë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime finaciare duke na mohur te drejt tone sipas LPP

9. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*